



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LORENC V. DAKA
ADRESA BLV'GJERGJ FISHTA', p.
nr.6, zyra nr.17
TEL: +355696557338

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2032

Nr. koleksioni: 847

Tirane më 03/06/2024

14

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2024053070096799038



KONTRATË SHITJE KUOTË KAPITALI
(TË SHOQËRISË "THE HOME" SH.P.K)

Sot, më datë 03.06.2024, para meje Noter LORENC V. DAKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV'GJERGJ FISHTA', p. nr.6, zyra nr.17, u paraqit personalisht:

SHITES: Marinela Lika, atësia Nevrus, amësia Satbere, shtetase Shqiptare, lindur në Shkodër dhe banuese në Tiranë, me adresë Arkitekt. Kasemi; Nd. Nr.24; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1001; Tiranë, lindur më 04/06/1978, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 029079880 dhe nr. personal H85604116R.

SHITES: Besa Fuga, atësia Mark, amësia Arjana, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Seit Teqja 03950073; Nd. 92; H. 1; Petrelë; Mullet; 1034; Tiranë, lindur më 02/06/1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033684758 dhe nr. personal I55602059U.

BLERES: Ledion Çollaku, atësia Gaqo, amësia Kostandina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Lagja 13, Rr Kodra Diellit; Nd. 44; H. 1; Ap. 8; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 16/01/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032988302 dhe nr. personal H70116044T.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lire e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave ligjore të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705 e vijues I tij si dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, bien dakord dhe kërkojnë nga unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shit-blerjes së Kuotave të Shoqërisë "THE HOME" shpk, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

- 1.Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 2.Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Neni 1. Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është shitja e 100% (njqind përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë THE HOME shpk, të cilat zotërohen nga Shitësi znj. Marinela Lika (perkatesisht 50 % te kuotave te kapitalit) dhe nga shitesja znj.Besa Fuga (perkatesisht 50 % te kuotave te kapitalit), tek bleresi z.Ledion Çollaku, sipas kushteve dhe çmimit të përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 2. Përmbajtja e Kontratës

2.1 Shoqëria THE HOME është regjistruar si person juridik më datë 23.04.2018 pranë Qendrës Kombetare të Biznesit me numër unik identifikimi NUIS L81623013B. Shoqeria THE HOME shpk

Fq. 1



zotërohet nga dy ortakët pjesëmarres znj. Marinela Lika e cila zotëron 50 % te kuotave te kapitalit, numri i pjesëve 1,00, znj. Besa Fuga e cila zotëron 50 % te kuotave te kapitalit, numri i pjesëve 1,00.

2.2 Shitësit Marinela Lika (50 % (pesëdhjetë përqind) ose 1 kuotë/nje pjese) dhe Besa Fuga (50% (pesëdhjetë përqind) ose 1 kuotë/nje pjese) kanë rënë dakord të shesin 100% (njqind përqind) te kuotave te kapitalit, në këtë shoqëri blerësit z. Ledion Çollaku.

2.3 Kjo kontratë lidhet në përputhje me Statutin e Shoqërisë tregtare THE HOME shpk dhe në përputhje me ligjin e aplikueshem.

2.4 Sa më sipër, realizohet shitja e 100% (njqind përqind) të kuotave te kapitalit të Shoqërisë THE HOME shpk te cilat zotërohen nga ana e shiteses Marinela Lika dhe Besa Fuga dhe blerja e ketyre kuotave nga ana e bleresit Ledion Çollaku.

2.5 Shiteset, Marinela Lika dhe Besa Fuga, ortakë të Shoqërisë THE HOME shpk janë plotesisht dakord dhe i shesin me vullnetin e tyre te lire e te plote Bleresit Ledion Çollaku 100 % (njqind përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë THE HOME shpk, kuota te cilat ata zotërojnë ne kapitalin e saj.

2.6 Bleresi, nga ana e tij, është plotesisht dakord qe te bleje 100% (njqind përqind) te kuotave kapitalit te Shoqërisë THE HOME shpk,

2.7 Shitësi deklaron dhe garanton me pergjegjesi te plote ligjore se shet 100 % (njqind përqind) te kuotave te Shoqërisë THE HOME shpk, të lira nga çdo barrë apo pretendim nga persona te trete.

2.8 Shitësi deklaron dhe garanton me pergjegjesi te plote ligjore se kuotat qe shiten sipas kesaj kontrate te permendura me lart dhe te drejtat qe rrjedhin per shkak të zoterimit te tyre, nuk jane subjekt i asnje procesi gjyqesor civil, penal, administrative apo procesi tjeter arbitrazhi brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

2.9 Bleresi deklaron se eshte ne dijeni te plote te situates ligjore dhe financiare te Shoqërisë, te aseteve ne pronesi te Shoqërisë dhe e pranon shoqërine sic eshte ne daten e transferimit te pronesise, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet.

Neni 3. Çmimi i shitjes së kuotave dhe Mënyra e Pagesës

3.1 Palët kanë rënë dakord që vlera totale e shit-blerjes së kuotave te kapitalit në masën 100 % (njqind përqind) e kuotave të Shoqërisë THE HOME shpk te zotëruara nga Shiteset, është e barabartë me një shumë prej 1000 Lekë (nje mijë leke), për të cilën është rënë dakord nga ana e pales blerëse z.Ledion Çollaku.

3.2 Pagesa per shumën e mesiperme eshte paguar para nenshkrimit te kesaj kontrate dhe jashte zyres noteriale.

3.3 Palet deklarojne se vlera totale e shit-blerjes se kuotave te kapitalit eshte likujduar plotesisht jashte kesaj zyre noteriale dhe palet nuk kane asnje pretendim tani dhe ne te ardhmen ne lidhje me menyren e pageses apo cmimin e shit-blerjes.

Neni 4. Transferimi i pronësisë

4.1 Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shiteset Marinela Lika dhe Besa Fuga, ortakë të Shoqërisë THE HOME shpk, humbasin pronesine mbi pjesët e tyre takuese sipas përqindjeve që ata zotërojnë ne kapitalin themeltar te Shoqërisë THE HOME shpk.

4.2 Bleresi z.Ledion Çollaku me nenshkrimin dhe noterizimin e kesaj kontrate dhe me miratimin nga ana e Asamblese se pergjithshme te Ortakeve te Shoqërisë THE HOME shpk behet pronar i vetem i

Fq. 2



100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit me 1 kuotë/një pjesë, duke fituar çilesinë e Ortakut të vetëm në këtë Shoqëri.

4.3 Me përfundimin e këtij transaksioni shit-blerje, blerësi, **Ledion Çollaku** do të zotërojë 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit në Shoqërinë **THE HOME shpk** që përfaqësojnë 1 kuotë/një pjesë.

Neni 5. Aneksat e Kontratës

Kësaj Kontrate i bashkëngjiten si pjesë përbërëse dhe e pandarë këto dokumenta që do të quhen Aneksa të kontratës.

- Ekstrakt i Regjistrimit tregtar për Shoqërinë **THE HOME shpk**
- Dokumentet e identifikimit të palëve
- Vendim i asamblese së ortakëve

Neni 6. Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e shit-blerjes së kuotave të kapitalit, u përpilua nga unë noteri në 5 (pese) shtypshkrime të barazvlefshme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Marinela Lika

Marinela Lika

BLERES

Ledion Çollaku

Ledion Çollaku

SHITES

Besa Fuga

Besa Fuga



[Signature]